

Sokol (Hysen) Dina

(29.10.1951, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, arsimtar, një fëmijë)

Ibrahim (Hysen) Dina

(1955, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, pensionist, një fëmijë)

Xhemile (Ismail Osa) Dina

(1945, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, një fëmijë)

Fatmir (Ibrahim) Dina

(6.10.1976, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac)

Hysen (Fahredin) Dina

(30.06.1978, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor)

Njësitet speciale të policisë nga Prizreni/Prizren dhe Gjakova/Đakovica kanë arritur në Rahovec/Orahovac në orët e vona të pasdites, më 18.07.1998. I bartnin uniforma të gjelbra. Herët në mëngjes të ditës së nesërme, më 19.07.1998, pjesëtarë të policisë serbe filluan të hynin në shtëpitë shqiptare – i bastisnin, kërkonin armë, shtënin në të gjitha anët, i hidhnin bomba dore në bodrume, plaçkitnin dhe u vënin zjarr shtëpive. Pjesëtarët e Brigadës së 549 të Motorizuar e bombarduan qytetin nga drejtimi i fshatrave Landovicë/Landovica [Prizren] dhe Rogovë/Rogovo [Gjakovë/Đakovica].

Shtëpitë e vëllezërve Ibrahim, Selami, Sokol dhe Fahredin Dina gjendeshin në dalje të **Rahovecit/Orahovac**, në drejtim të fshatit Xërxë/Zrze, në mes të ambulancës dhe pikës së karburanteve *Jaha Petrol*. Herët në mëngjes, në datën **19.07.1998**, shumica e anëtarëve të familjes Dina u aratis nga qyteti. Në shtëpi mbetën: Ibrahim, bashkëshortja Xhemilja dhe djali Fatmiri me bashkëshorten e vet Elviren; dhëndri i Ibrahimit, Sokoli dhe bashkëshortja e tij Gjylsyme me djalin Muhamedin; vëllai i Ibrahimit dhe Sokolit, Selamiu, dhe Hyseni, djali i Fahredinit. Për shkak të bombardimit, të gjithë zbritën në bodrum. Në një pjesë të bodrumit ishin Ibrahim, Xhemilja, Fatmiri, Sokoli, Hyseni dhe Selamiu, ndërsa në pjesën tjetër Muhamedi, Gjylsymbja dhe Elvira. Pas dite, te shtëpia erdhën policët. Pa asnjë paralajmërim, i hodhën disa granata dore në bodrum. Nga

ato vdekjen e gjetën Ibrahim, Xhemilja, Sokoli, Hyseni dhe Selamiu. Fatmiri ishte i plagosur. Atë të plagosur në oborr e panë Muhamedi, Gjylsymbja dhe Elvira, që ikën me vrap kur i dëgjuan shpërthimet e bombeve dhe të shtëna. Po atë ditë, policia serbe i ka marrë trupat e të vrarëve dhe i ka çuar me kamion në drejtim të panjohur. Në bodrum ka mbetur vetëm trupi i Selamiut. Ditën tjetër, trupin e tij e ka gjetur i vëllai Fahredini. Me ndihmën e një komshiu e varrosën në oborr. Në muajin gusht të vitit 1998, familjarët e kanë rivarrosur Selamiun në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Mbetjet mortore të Hysenit, Xhemiles dhe Ibrahimit u gjetën pas lufte në varrezat përkaj grupës me bërlllok [prapa varrezave myslimane]. Mbetjet mortore të Hysenit u varrosën në varrezat myslimane më 8.04.2005, të Xhemiles më 15.07.2005, ndërkaq ato të Ibrahimit më 28.05.2007. Sokoli dhe Fatmiri ende konsiderohen të zhdukur. Në listën e KNKK-së, zhdukja e Sokolit është evidentuar në lëndën që e mban numrin BLG-803855-01, ndërsa ajo e Fatmirit BLG-803601-01.

Burimet: deklarata A.C, FDH-851; deklarata N.N, FDH-853; deklarata F.D, FDH-12927; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; OMPF, *Mbetjet...*, FDH-15297; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. 6D00614, FDH-35527.

Haxhi (Sahit) Kastrati

(1905, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tre fëmijë)

Haxhiu jetonte në bashkësi familjare me vajzën Xhyfen dhe dhëndrin Sylejmanin. Ishte i palëvizshëm. Në pasditen e datës **19.07.1998**, që të gjithë gjendeshin në shtëpi [**Rahovec/Orahovac**], kur policia ka hyrë në shtëpinë e familjes së Ibrahim Dines [të shikohet regjistrimi më lart], e cila gjendej afro 100 metra nga shtëpia e tyre. Kanë dëgjuar të shtëna dhe Xhyfa me bashkëshortin menjëherë u larguan nga shtëpia. U strehuan te komshiu Ibrahim Hajda. Pas afro pesë apo dhjetë minutash kanë parë se tetë policë kanë hyrë në shtëpinë e tyre. Pastaj i dëgjuan të shtënat.